



Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 06-6293 2026

Klinë, 02.03.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I-rë Kuvendit të Komunës mbajtur me datë 30 Janar 2026, në orën 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Të pranishëm në mbledhje: Kryetari i komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, nënkryetari i Komunës, z. Fadil Gashi, anëtarët e Kuvendit, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të OSBE, media dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Berisha i cili përshëndeti të pranishmit dhe ai kërkoi që të bëhet plotësim ndryshimi i mandateve, d.m.th. anëtarëve që janë emëruar drejtor dhe të tjerët që kanë ardhur në vend të tyre dhe të bëhet betimi, të lexohet deklarata e betimit.

- Janë tërhequr nga mandati i anëtarit të Kuvendit: Qendrim Millaku, Enver Berisha, Qemajl Sejdiu dhe Iliriana Toplanaj, ndërsa zëvendësohen nga Lorenc Marleku, Shemsi Bajraktari, Blerta Gashi dhe Florentina Berisha.
- Lexohet deklarata e betimit dhe njëzëri shqiptohet fjala BETOHEM nga anëtarët e rijnë të Kuvendit të cilët edhe e nënshkruajnë deklaratën e shkruar.

Kryesuesi tha se në këtë seancë materiali është voluminoz, janë pika që janë grumbulluar që tre muaj. Janë kërkesa dhe obligime që kemi edhe si ekzekutiv edhe si legjislativ.

Kishte vërejtje në dërgimin e materialit shkaku i e-mail-ve të rijnë që disa nga anëtarët e kuvendit akoma nuk i kanë marrë. Në këtë frymë vërejtje kishte edhe anëtari Naim Musliu, i cili mes tjerash tha se mungon pika e rendit të ditës: Pyetje dhe Përgjigje të cilën propozoj që të shtohet. Po ashtu meqenëse mungon materiali për disa pika shkaku që s'ka ardhur në email, nuk dimë se çka të diskutojmë, tha ai.

Edhe anëtari tjetër i kuvendit z. Esat Raci tha se para se të hyjmë në aprovimin e rendit të ditës ka disa kërkesa: 1. Gjatë kësaj seancë ose të shkurtit të sjellët materiali i anëtarëve të komisionit për dëmet e vërshimeve. 2. Si grup i PDK-së, pasi që nuk është pikë e rendit të ditës zgjedhja e shefave të grupet kuvendare, ne PDK kemi Naim Musliun

shef të grupit tonë. 3. Pika 23 në rend të ditës nuk ka material, unë skam asnjë material për këtë pikë.

Kryesuesi tha se e theksoi që në fillim se rendi i ditës është shumë i ngarkuar dhe se ka problem në dërgimin e materialit edhe si shkak i volumit të madh të materialit. Për shefat e grupeve kisha plan që mbas aprovimit të rendit të ditës të bëhet zgjedhja e tyre. Ajo që tha Naim Musliu, vetëm disa anëtarëve të rijnë nuk ju ka shkuar materiali të tjerëve po. Sa I përket pikës 23, raporti financiar, nëse ju mendoni që të hiqet nga rendi i ditës, jemi këtu që ta diskutojmë shtyrjen e saj për seancën e ardhshme. Për komisionin dhe raportin e dëmeve të vërshimeve do ta kemi në seancën e shkurtit.

z. Valmir Bacaj tha se problemet me dërgimin e materialit janë shkak i email private në të cilat nuk ka shkuar shkak i volumit të madh. Ne dakordohemi që ta shtyjme pikën 23 për mbledhjen e shkurtit, tha z. Bacaj.

Me vota unanime u miratua shtyrja e kësaj pike.

Për kërkesën e pikës : Pyetje Përgjigje, shkak i materialit të shumtë, pikave të shumta nuk e kemi fut në këtë rend dite.

z. Naim Musliu: Pavarësisht sa material ka ne jemi të obliguar që të I diskutojmë shumë çështje. Edhe kjo pikë është e nevojshme që të futet. Kemi nevojë për përgjigje të caktuara nga ekzekutivi dhe nëse është nevoja rijmë deri në mbrëmje, për këtë punë paguhemi, tjetër detyrë nuk kemi.

Kryesuesi e vendosi në votim kërkesën për pikën shtesë Pyetje dhe përgjigje

Me vota unanime 24 për u MIRATUA futja në rend të ditës të pikës Pyetje- Përgjigje.

Rendi i Ditës u vendos në votim dhe me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Kryesuesi z. Enver Berisha në vazhdim kërkoj që të epen emrat e shefave të grupeve kuvendare.

U propozuan:

AAK- Valmir Bacaj

PDK- Naim Musliu

LDK- Arben Limanaj

Znj. Marigona Racaj: Kërkoj që pika e rendit të ditës për zgjedhjen e anëtarit të KPF të shtyhet pasi që nuk kemi vendosë akoma se kush do të jetë nga radhët e LDK-së.

Kryesuesi tha se propozimet dhe votimet le të vazhdojnë ndërsa ju grupi kuvendar të na e epni emrin më pastaj.

Në këtë çështje u inkuadruan edhe Valmir Bacaj, Esat Raci etj.

Pika 1 e rendit të ditës: Arsyetimi i mungesave

- **Mungon vetëm anëtarja Arlinda Selitaj**

Pika 2 e rendit të ditës : Shqyrtimi dhe miratimi I procesverbalit nga mbledhja e kaluar

- **Me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

Pika 3 e Rendit të ditës: Themelimi i KPF-së

- Çelësi: 2 nga AAK, 2 nga PDK, 1 nga LDK, 1 nga LVV

Esat Raci kërkoj që PDK ti ketë tre anëtar të KPF-së. Armend Beqiri kërkoj që AAK si grupi më i madh ti ketë tre anëtarë të KPF-së. Naim Musliu tha se Kuvendi është organ që e ndihmon ekzekutivin prandaj për të mirë të demokracisë është mirë që propozimi i Esat Racit të merret parasysh. Raporti mes të pushtetit dhe opozitës të jetë më i balancuar. Valmir Bacaj tha se asambleja nuk është fontanë dëshirash. Kjo rregullohet sipas udhëzimit administrativ (e lexoj udhëzimin në fjalë)Aleanca në këtë rast sipas udhëzimit I ka 2 + kryesuesin, PDK I ka 2, LDK I ka 1 dhe LVV e ka 1.

Kryesuesi tha se sa i përket demokracisë dhe balancimit që e tha Naim Musliu, në këtë komitet janë 4 anëtarë nga opozita nga gjithsejtë 7 sa i ka ky komitet.

Esat Raci tha se i kanë të njohura këto udhëzime por për një demokraci të shëndoshë kërkuam që PDK ti ketë 3 anëtarë. Ndërsa Naim Musliu shprehu dilemën për LDK nëse është opozitë apo pozitë.

z. Fadil Gashi, nënkryetar i Komunës: Përshëndetje të gjithëve dhe urime të gjithëve. Kemi punuar shumë bashkë me pjesën dërmuese këtu. Ne kemi pasur raste nga më të ndryshmet në këtë kuvend, kemi venë anëtar e kemi heq anëtarë , kemi zëvendësuar dhe kemi prit që parit atë na delegoj anëtar edhe nga dy muaj. S` ka asgjë të keqe. Nëse nuk ka emër LDK, kurdo që të na e sjell anëtarin mund të plotësohet. Nëse i referohemi rezultateve të zgjedhjeve dhe këtij çelësi, mendoj se mund të gjeni mirëkuptimin që të procedohet. Sa i përket përgjigjes se ne LDK a jemi opozitë a nuk jemi, do ta merr vesh me kohë. Të njoftoj që deri me tani nuk ka marrëveshje por është duke u punuar për marrëveshje qeverisëse. Gjithmonë e kemi gjetë çelësin dhe mirëkuptimin, nuk pengon asgjë nëse ja leni hapësirën, zbrazëtinë LDK e cila e plotëson kurdo që ta ketë qëndrimin e vetë. Edhe një herë ju uroj të gjithëve dhe apeloj që të jemi bashkë në të gjitha çështjet.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje të gjithëve. Propozoj që të shkohet me çelës që u tha por LDK mund ta jap sot propozimin dhe kanë të drejtë që ta ndërrojnë kur të duan.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje. Urime kryesues për detyrën ty dhe gjithë anëtarëve të kuvendit. Mendoj që formulën që kemi pasur atë ta respektojmë se ky është rezultat i besimit të qytetarëve. Sa i takon asaj se ku jemi si subjekt politik, as ne nuk e dimë për subjektet politike se ku do të jenë nesër. Në vazhdimësi në këtë mandate do ta vazhdojmë

gjuhen e komunikimit demokratik. Shpresojmë që puna e jonë të reflektoj në të mirë të qytetarëve.

Z. Naim Musliu: Vetëm një sqarim se më duket u keqkuptuam. Nuk e kam hall unë se a bëni koalicion a nuk bëni por që të definohet pozita e LDK.

Çelësi 2+2+1+1 dhe kryesuesi u vendos në votim dhe me vota shumicë u MIRATUA
Edhe propozimi I PDK që ti kenë 3 anëtarë të KPF-së u vendos në votim dhe me shumicë votash u hodh poshtë.

Tek propozimet për anëtarë të KPF-së përveç AAK-së që bëri dy propozime ,dhe LVV , as PDK dhe as LDK nuk ishin të gatshëm që të japin propozimet e tyre në këtë moment. Përfaqësuesit e këtyre grupeve kërkuan që emrat e propozuar të epen në një seancë tjetër.

z. Esat Raci: Për hirë të korrektësisë dhe punës së përbashkët ne dakordohemi me çelësin. Puna mund të vazhdoj, Komiteti mund të funksionoj dhe në ndërkohë më vonë ne jua sjellim dy propozimet tona.

Kryesuesi z. Berisha tha se vendimi I kuvendit për këtë çështje do të shkoj në ministrinë e pushtetit lokal për ligjshmëri dhe ky vendim I pa plotësuar me anëtarë të KPF-së nuk do të miratohet si I ligjshëm e do të na kthehet për rishqyrtim. Prandaj më mirë të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës

U kërkuar që të shtyhet si pikë e rendit ët ditës, gjithashtu pat zëra që të vazhdohet sepse dy grupe që bëjnë shumicën I dhanë propozimet dhe pat propozime(Arben limanaj) që të epet 15 minuta pauzë në mënyrë që grupet e PDK dhe LDK të konsultohen dhe në vazhdim të japin propozimet e tyre.

Jepen 15 minuta pauzë për konsultime.

Pas pauzës prej 15 minuta anëtarët kthehen në sallë dhe vazhdon mbledhja. Kryesuesi z. Berisha kërkon që grupet kuvendare nga PDK dhe LDK të japin propozimet për anëtarë të KPF.

z. Esat Raci: Pasi që pushteti nuk u tregua zemërgjerë, grupi kuvendar I PDK propozon znj. Mendehe Duraku dhe Esat Raci.

z. Arben Limanaj: Grupi kuvendar I LDK propozon Arben Limanaj për anëtar të KPF-së LVV e kishte propozuar znj. Tetuta Mulaj

AAK- Valmir Bacaj dhe Arlinda Selitaj

Marigona Racaj: Propozoj që të shtyhet për seancën tjetër kur të marrim një vendim më të plotë mes nesh, nuk kemi qëndrim.

Kryesuesi tha se shefi I grupit kuvendar i LDK e dha propozimin, po del pak e komplikuar por unë do ta vendos në votim se kush është për këta emra të propozuar.

Me 1 kundër dhe 1 abstenim MIRATOHET me shumicë votash.

Propozimet për anëtarë të komitetit për komunitete; Çelësi është 4 anëtarë nga komunitetet dhe 3 nga kuvendi.

AAK- Leonora Dakaj

PDK- Kushtrim Haliti

LDK-Ndrec Zefaj

Komuniteti Serb- Marko Nedelkovic

Komuniteti Rom- Nexhmedin Gashi

Komuniteti Egjiptas – Almiresa Kerrelaj

Komuniteti Ashkali- Vehbi Alaj

Me 20 vota për, 2 abstenime, kundër asnjë, MIRATOHET

Kryesuesi tha se ka bërë një kapërcim të vogël tek procesverbalin e takimit të dytë të kryetarit me qytetarë, që nuk e ka vendos për shqyrtim. Nëse ka dikush diçka për të thënë urdhëroni.

Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi I Planit të punës së ekzekutivit për vitin 2026

z. Zenun Elezaj, kryetar i komunës: Përshëndetje të gjithëve. Ne kemi punuar një plan të punës së ekzekutivit për vitin 2026 bazuar në kërkesat e qytetarëve të bëra në kuadër të debateve publike si dhe kërkesat e qytetarëve të bëra me shkrim. Gjithashtu bazuar në strategjinë e zhvillimit ekonomik dhe dokumentet e tjera strategjike dhe në harmoni me buxhetin e komunës. Ju e keni të shkruar dhe nëse ka sugjerime apo propozime urdhëroni.

z. Naim Musliu: Prandaj edhe e ngrita si shqetësim në fillim të seancës pasi që ne nuk e kemi pasur materialin prandaj nuk dijë se çfarë të debatojmë, as të propozojmë as lavdërojmë. Nëse është puna tek email zyrtar kërkoj që mos të përsëritet sepse nuk është praktikë e mirë.

Kryesuesi kërkon që anëtarët e kuvendit të interesohen dhe rregullojnë email tek IT e Komunës. Nga sot të gjithë i kanë email zyrtar dhe nuk besoj që do të ketë problem.

z. Arben Limanaj: Ndoshta lidhet edhe me planin e prokurimit që dua ta përmend. Drejtoria e arsimit planifikimin që ka bërë në vitin 2026 shkollat me qenë pa ngrohje është planifikim i keq. Peleti, ditarët, shkumësat janë çështje teknike që nuk guxojmë me i bë llaf në 2026. Duhet të diskutojmë çështje të mësim dhënies dhe mësim nxënies. Këto gjëra duhet të përmirësohen në të ardhmen.

z. Valmir Bacaj: Ne planin e punës për vitin 2026 e kemi pranuar dhe është një plan i punës i hartuar nga nevojat dhe kërkesat e qytetarëve si dhe dëgjimeve publike. Ne jemi për miratimin e këtij plani të punës së ekzekutivit.

z. Enver Berisha, kryesues tha se besoj që ju keni qenë vet në proceset e arsimit dhe e dini që ditaret nuk varen nga ne por nga niveli qendror. Sa i përket ngrohjes besoj që janë rregulluar ato çështje por nëse keni ndonjë propozim konkret mund të diskutohet.

z. Zenun Elezaj, Kryetar: Nëse ka diçka konkrete në kuadër të pyetje dhe përgjigje mund ti diskutojmë të gjitha çështjet që paraqiten. Përndryshe ne kemi kontratë edhe për pelet, edhe për shkumësa edhe çështje të tjera teknike.

Me 1 abstenim, asnjë kundër dhe 20 vota për, MIRATOHET

Pika 6 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të prokurimit

z. Labinot Morina, shef i zyrës së prokurimit: Përshëndetje të gjithëve. Bazuar në ligjin e aprovuar në asamble, zyra e prokurimit ka bërë planin e prokurimit për vitin 2026 bazuar në kërkesat e drejtorive. Janë paraparë 90 procedura gjithsejtë.

Z. Morina shpjegoj veç e veç të gjitha e procedurave të parapara në buxhet.

z. Esat Raci: Uroj të keni punë të mbarë në vitin 2026 pa asnjë ndërhyrje as nga jashtë as nga Brenda.

Me 1 abstenim, asnjë kundër dhe 20 vota për MIRATOHET

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së kuvendit

Me 21 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim MIRATOHET

Pika 10 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për harmonizimin e Hartave Zonale

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizimit: Përshëndetje të gjithëve. Ju jemi drejtuar kuvendit që të bëhet miratimi i harmonizimit të hartave zonale. Vitin e kaluar e kemi miratuar planin zhvillimor komunal dhe kjo duhet të jetë në harmoni me hartat zonale. Sipas këtij dokumenti ne fillojmë procedurat që hartat zonale të revidohen sipas PZHK.

z. Isa Ibishi: Përshëndetje të gjithëve. Po e konsideroj që kjo është një nga pikat më të ndjeshme dhe më të nevojshme që e prek drejt për drejt qytetarin e Klinës. I përgëzoj gjithë ekzekutivin në krye me kryetarin Elezaj që e kanë hartuar këtë plan. Ka qenë e nevojshme sepse mbi 5 vite qytetari ynë ka ra në desh me planin zhvillimor dhe hartat zonale. Është një ogur i mirë revidimi i HZ. Uroj që sa më shpejtë që të revidohen hartat zonale. Urime për punën e bërë.

Me 21 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim MIRATOHET

Pika 11 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i publikimit të listave të përgjithshme të pronës komunale.

Kryesuesi tha se janë dy pika të rendit të ditës që kanë të bëjnë me pronat.

z. Nikson Dakaj, drejtor i kadastrit: Përshëndetje. Më lejoni që para juve të paraqes listat e përgjithshme dhe listat e veçanta të pronave komunale. Duke u bazuar në ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, drejtoria ka përgatitur këto dy lista.

Kryesuesi tha se drejtori i përfshiu të dy listat. Kush është për listën e pronave të përgjithshme?

Me 21 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim MIRATOHET regjistri I pronave komunale

z. Naim Musliu: Mendoj që është e nevojshme që të debatojmë pak këtë pikë. Ne jemi dakord për dhënien në shfrytëzim të pronave por nuk jemi dakord që zënia e hapësirave publike e të pengojnë lëvizjen e qytetarëve. Gjithashtu për çfarë ka shumë ankesa është bllokimi I parkingjeve publike. Nuk e diji sa është e arsyeshme që një kompani të bllokoj një parking publik.

Kryesuesi tha se fjala është për listat e pronave që komuna I jep në shfrytëzim. Pas shpjegimit që dha kryetari I komunës për këtë çështje, kryesuesi e vendosi në votim listën e pronave të veçanta ku komuna I jep në shfrytëzim për vitin 2026.

Me 21 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim MIRATOHET

Pika 12, 13 dhe 14 e Rendit të Ditës

Fjalën e merr nënkryetari I Komunës, z. Fadil Gashi shkaku se bëhet fjalë në këto pika të rendit të ditës të natyrave të njëjta kur nënkryetari ka qenë kryesues I kuvendit.

z. Fadil Gashi, nënkryetar: Këto tre shkresa – vendime na I kanë kthyer për rishikim dhe ne nuk kemi pasur mundësi të I rishikojmë sepse nuk ka pasur kuvend, kanë qenë zgjedhjet lokale. Për këto tre çështje ministria na ka dërguar në gjykatë pa të drejtë pasi që s` ka pasur kuvende, me 12 tetor e kemi kryer procesin e zgjedhjeve dhe këto kërkesa kanë ardhur akoma pa e përfunduar procesin zgjedhor. Ne duhet që të I pezullojmë për momentin të tri vendimet e kërkuara. Deri sa të vjen epilogu I kësaj çështje nuk mund të I procedojmë, ju këshilloj që të I pezullojmë.

Me 20 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA pezullimi I të tre vendimeve

Pika 15 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I propozim vendimit për themelimin e komisionit për emërtimin e rrugëve , shesheve...

Kryesuesi tha se ky komision përbehet nga 9 anëtarë. 4 nga kuvendi dhe pjesa tjetër nga ekspertët.

z. Kushtrim Haliti: Përshëndetje të gjithëve. Unë kam qenë shef I këtij komisioni dhe e kemi përfunduar punën, raportin e kemi dërguar në ministri. Na kanë thënë që rrugët që I kemi emërtuar nuk është dashur që të emërtohen pa kaluar 5 vite. Në momentin që

votohet komisioni për riemërtime d.m.th. që mund të ndryshojmë por në ministri na aknë thënë që nuk mund të riemërtohen rrugët pa kaluar 10 vite. Janë thirrur në ligjin e viti 2019. Sipas kësaj deri në 2029 nuk mund të bëjmë riemërtime të rrugë. Për këto riemërtime na kanë dërguar edhe në gjykatë.

z. Enver Berisha, kryesues: E kuptoj Kushtrim por ne nuk kemi pasur mundësi rishikimin e vendimeve tona sepse siç e shpjegoj nënkryetari. Kjo nuk na pengon që ne të formojmë komisionin e ri për emërimin dhe riemërimin e rrugëve. Çelësi është nga AAK 2 , nga PDK 1 dhe nga LDK 1

u propozuan:

1. Armend Beqiri
Luigj Ademi
 2. Asdren Ramadani
 3. Jehona Gashi
- Esat Raci dhe Arben Limanaj shprehen shqetësimin dhe kërkesën që ky komision të paguhet me rregull.
 - Kryetari I komunës tha se ka pasur problem procedural por që të gjitha komisionet do të paguhen.

Me 21 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA

Kryesuesi tha se janë tre pika të rendit të ditës që aknë të bëjnë me Shtimi I buxhetit për mekanizmat bujqësor, të ardhura nga drejtoria e Bujqësisë.

Znj. Ilirjana Toplanaj, drejtore e Bujqësisë: Fjala është për shtim të buxhetit për participimin e fermerëve.

z. Kushtrim Haliti: Do të donim që të dinim se ku po merren këto mjete. Po ashtu mendoj që është e paligjshme që në fillim të zgjedhën përfituesit e pastaj të ndahen mjetet. Kërkoj që në seancën e ardhshme nga komisioni I ndarjes së këtyre mjeteve të na raportoj e tregoj se si ka mundësi që ka persona që rijnë e jetojnë në banesa, jetojnë në fushë Kosovë dhe kanë përfituar nga këto mjete. Një frezë ju ka dhënë një personi të Komunës së Skenderajt dhe e kanë bërë banorë të Jashanicës. Unë e di se nga Jashanica jam, ai person nuk ka prona e shtëpi në territorin e Jashanicës. S` di si kanë mundur me a bë këtë punë.

Znj. Jehona Gashi: kam disa shqetësime nga qytetarët. Atyre ju kanë dalë emrat si përfitues por nuk kanë marrë akoma freza. Kur kanë me I marrë këto freza dhe pse nuk I kanë marrë deri tani.

Znj. Ilirjana Toplanaj, drejtore e Bujqësisë: Fermerët që kanë përfituar do të I marrin të gjithë frezat javën e ardhshme.

Kushtrim Haliti: Kush e merr përgjegjësinë për personin që ka përfituar pa qenë banor I Klinës. Unë kam pyet zyrtarin se pse I kanë dhënë dhe me ka thënë se I ka dhënë dhe prap kanë me I dhënë.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Është përgjegjësi e komisionit. Ne kemi problem të tilla me personat që kanë prona në komunën e Klinës edhe pse janë nga Skenderaj apo Malisheva. Por kusht është që prona të jetë në komunën tonë, pra kjo është përgjegjësi komplet e komisionit.

z. Naim Musliu: Duhet të sqarohen të gjithë qytetarët e Klinës se PDK ka qenë dhe është gjithmonë në krahë të fermerëve por është kundër keqpërdorimit. Me 12 tetor të vitit 2025 janë mbajtur zgjedhjet e rundit të parë. Në mes të dy rundeve të zgjedhjeve keni bërë ndarje të mjeteve bujqësore që është shkelje e hapur e ligjit të zgjedhjeve. Çfarë urgjence kishte Komuna e Klinës që të shpallë ndarje të mjeteve bujqësore në mes të dy rundeve zgjedhore kur ka pasur mundësi që kjo të bëhet në pranverë. Ju po kërkon që ne të jua legjitimojmë këtë blerje të votave zgjedhore. Është një çështje që do ta diskutojmë tek pyetje e përgjigje: Është dënimi që komuna e Klinës është dënuar me 20 mijë euro për publikimin e të dhënave personale në web faqe të Komunës. Me 20 mijë euro Komuna ka pasur mundësi që të blej 20 fotokopjues për shkolla pasi që mësimdhënësit nuk kanë ku të bëjnë fotokopje. Me aq pare keni pasur mundësi me t'ble 20 tabela të mençura ose me ble pelet.

Në këtë pikë nis një debat interaktiv në mes të kryesuesit dhe z. Naim Musliu që është e pamundur të përcjellët në procesverbal.

z. Armend Beqiri: Dëshiroj të lidhem tek pika e rendit të ditës. Dua të kem parasysh parafolësin se së pari ka informata shumë të pa sakta. Publikimi i listës përfituese nuk ka ndodhur në mes të dy rundeve zgjedhore. Publikimi i listës së fermerëve ka ndodhur në janar një muaj pas zgjedhjeve. Tek blerja e votave shihet se cila parti ka ble vota më shumë.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Ajo që po e thotë Naimi ka të bëjë me prokurimin. Janë shpallur procedurat dhe pasi të lidhet kontrata behet shpallja. Ne e kemi ditur që në të kaluarën kanë qenë 200 aplikues për 100 sera por e kemi rritur numrin e serave që të përfitojnë të gjithë. Kushtet për përfitim duhet të plotësohen gjithsesi. Kjo që po flasim tani mendoj që nuk është momenti por nëse ka raste të tilla ju kisha lutur me emër e mbiemër sepse unë nuk mund të i dijë të gjitha. Qëllimi im është që të i shërbejmë qytetarët pa dallim.

z. Kushtrim Haliti: Armendi na përfshiu të gjithëve për vjedhje votash. Ndoshta këta tanët kanë vjedhë më shumë por as ju nuk ja keni lënë mangët por nuk keni pasur ku me vjedhë sepse nuk i keni pasur 23 deputet.

z. Valmir Bacaj: Unë kërkoj që të qëndrojmë në rend të ditës. Ju propozoj anëtarëve të kuvendit tërijnë që të i konsultojnë ligjet dhe rregulloret e Kuvendit që të dinë se kur kanë të drejtë të flasin dhe të kenë kujdes kur përmendin vjedhje votash sepse këtu ka procesverbal që mbahet dhe mund të ketë pasoja. Nuk mund të flasim fjalë kafe e rrugëve në Kuvend në organin më të lartë të Komunës prandaj duhet kujdes në çdo fjalë që nxjerrim. Në fund, ne jemi për miratimit të këtyre pikave.

z. Naim Musliu: Unë e diji kur kam të drejt e kur s` kam të drejt që të flas, të gjithë e dimë besoj. Ne si grup kuvendar jemi kundër dhe nuk legjitimojmë buxhetin e shfrytëzuar për blerje të votave.

Kryesuesi dhe drejtoresha e Bujqësisë shpjegoj që fjala është për fermerët që kanë participuar

z. Tunë Dedaj: Kur është në pyetje për fermerët dhe participimi I tyre unë jam pro.

z. Fadil Gashi, nënkryetar: Ju informoj që në mandatin e kaluar unë kam dështuar që ta bind dike se çfarë është debate. Po çuditë me anëtarët e vjetër sepse e dinë. Procedurat për të cilat po flasim janë të miratuara nga plani I prokurimit nga një mandate tjetër. Në shtator ju do të votoni buxhetin për vitin e ardhshëm. Nuk po ndërhyj se a ka shkelje apo nuk ka. Unë bashkë me ju edhe kryetari gjithashtu do të kemi dhe debatojmë një raport nga komisioni në fjalë në seancën e ardhshme por kjo s` ka të bëjë me piken për të cilën po flasim. Fjala është për participimin e fermerëve. Këto mjete nëse nuk shkojnë në destinacionin e duhur, na humbin dhe nuk besoj që ndonjëri nga ju dëshiron këtë gjë.

Pika 16, 17 dhe 18 e Rendit të ditës vendosen në votim dhe me 13 vota për, 7 kundër dhe asnjë abstenim MIRATOHET

Pika 19 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi I raportit për performancën e komunë së Klinës për vitin 2024

z. Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Përshëndetje të gjithëve. Ne si Komunë ju informojmë se sa I përket angazhimit të administratës ka treguar një performancë të jashtëzakonshme dhe jemi përfitues I grandit. Indikatorët e performancës janë të përcaktuar nga niveli qendror por janë të zbatuara në përpikëri nga zyrtarët tanë. Zyrtari për mbledhjen e informative për plotësimin e këtyre indikatorëve me përkushtimin më të madh I ka mbledhur dhe prezantuar ata indikatorë. Komuna I ka kryer në kohën e duhur sipas afatit të përcaktuar. Këtë vit presim jemi ndër 6-të komunat që kemi përfituar Grandin qeveritar. Shpresojmë që të jetë sa më I madh ai grand gjë që akoma nuk e dimë se sa do të jetë, dhe shpresojmë që në të ardhmen të vazhdojmë kështu. Nëse keni pyetje shtesë jemi këtu që të përgjigjemi dhe prezantojmë të gjitha. Pra, edhe një herë jemi poentuar 100% si komunë.

Pika 20 e Rendit të Ditës: Raportimi i realizimit të planit për integritet për vitin 2025

z. Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Në pajtim me nenin 25 të ligjit Nr. 08/1-017 ligjit për agjencinë për parandalimin e korrupsionit dhe në përputhje me metodologjinë planit për integritet obligon të gjitha komunat të hartojnë planin për integritet. Kryetari I komunës formon një grup punues dhe hartojnë planin për integritet. Ne e kemi të hartuar planin në vitin 2024. Ky plan hartohet çdo dy vite. Duke I falënderuar edhe raportuesit, zyrtarin raportues, falë angazhimit të zyrtarit që ka raportuar është bërë edhe hartim I këtij plani në dhjetor të vitit 2025. Të gjithë akteret komunal duke I përfshij zyrtarët përgjegjës janë konsultuar dhe I kanë mbledhur të gjitha të dhënat të cilat janë publikuar në web të

komunës, prandaj ne si komunë jemi radhitur krahas komunave të tjera si realizuese në plotësi të planit të integritetit. Faleminderit për vëmendje.

Pika 22 e rendit të Ditës: Raporti I kryetarit të Komunës për rrjedhjen e punës për vitin 2025.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Ne jemi të obliguar që të informojmë kuvendin për të gjitha punët që kemi bërë gjatë vitit kalendarik. Besoj që edhe në procesverbalin e takimit me qytetarë në fund vit e keni lexuar dhe skam çfarë të shtoj më shumë.

Pika 24 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i petitionit të nënshkruar nga banorët e lagjes “Azem Desku” në Klinë.

Kryesuesi tha se këtu është përfaqësuesi i lagjes i cili është gati të shprehë shqetësimin para juve.

z. Fehmi Geci, përfaqësues i lagjes “Azem Desku”: Të nderuar të pranishëm. Si përfaqësues i lagjes në rrugën “Azem Desku” kam ardhur që të ju rrëfej për një problem që e ka shkaktuar komuna e Klinës që ka impakt në pasigurinë e përhershme të kyçjes së banorëve në rrugën kryesore. Paraprakisht dua të i drejtohem kryetarit të komunës për tri çështje. 1. Kryetari i Komunës ka qenë i njoftuar për këtë problem prej vitit 2019, dhe premtimi i tij që ne të bëjmë një kërkesë dhe do të rregullohet. 2. Kryetari i Komunës para dëgjimit buxhetor në vitin 2024 ka qenë në vend dhe prap e ka lejuar dhënien e lejes së ndërtimit një banori ku janë dy kërkesa, parcelë të infra kosit që nuk është parcelë komunale por në bazë të ligjit është e autorizuar që të përmirësoj gabimin, kyçja e rrugës “Azem Desku” është ndryshuar në vitin 2013 nga Komuna dhe është e vetmja rrugë që ju ka bërë traseja legale në Kadastër. Kërkesa e banorëve të lagjes ka qenë kthimi i rrugës në gjendje të mëparshme. Krijimi i parakushteve për lëvizje të lirë. Për arsye se ndryshimi i trasesë nga pronari privat jashtë çdo rregulli e ligji si dhe rregulloreve për prona të infra kosit, e ka ndryshuar gjendjen e rrugës dhe faktikisht e ka bërë përjetësisht paradoks për ndryshim të rrugës. Ne qëndrojmë pranë kërkesës që traseja e rrugës “Azem Desku” të kthehet në gjendjen e mëparshme para vitit 2013. Paradoksi i kryetarit Zenun Elezaj kur në debatin zgjedhor me date 26. 10. 2025 ka deklaruar dhe korrigjuar drejt kandidatin tjetër të LVV, duke thënë se nuk kemi mundur të ndërhyjmë në këtë rrugë për arsye të kontestit që i bëjnë familja – familjes. Kryetar nuk mund të jetë kontest prona shoqërore mes dy familjeve dhe kërkoj që ta debatoni atë që e keni thënë në debat zgjedhor. Kjo gjë mund të krijoj edhe problem në mes të dy familjeve që në fakt nuk ekziston. Në realitet Komuna e Klinës ja ka dhënë lejen ndërtimore një personi pa e shikuar gjendjen e rrugës dhe e ka krijuar pengesë serioze për ekzistencën e banorëve aty.

(ka ndërhyrje nga anëtarë të Kuvendit në fjalën e z. Geci dhe bëhet debat interaktiv që nuk mund ta përshkruaj mbajtësi i procesit)

Me datë 21. 3 . 2024 banorët i drejtohen me kërkesë drejtorisë së inspektoratit që të ndryshojë rruga e të kthehet në gjendje të mëparshme. Na është thënë se kërkesa është

drejtuar gabimisht duke rekomanduar drejtorinë e urbanizimit. Edhe në këtë rast Komuna ka bërë shkelje sepse çdo institucion shtetëror edhe nëse I behët gabim kërkesa ai e ka kompetencën që ta drejtoj në organin e duhur. Me 17. 04. 2024 kemi marrë përgjigje nga drejtori I Urbanizimit se pengesa është se prona është e infra kosit. Me ligjin për menaxhimin e pronës publike, Komuna çdo aset shtetëror që vërtetohet se duhet shpallet zonë e interesit e ka kompetencë që të zhvilloj procedura për kalimin në pronë të komunës. Kuvendi dhe kryetari I Klinës nuk ka zbatuar kompetencën e vet por kanë luajtur lojë tinëzare duke zgjatur çështjen derisa ju ka dhënë leje ndërtimore një personi. Për çështje administrative realisht është një komunikim në mes meje dhe në mes të drejtorit Faruk Ismaili. Me 7 . 5. 2026 (me siguri ka gabuar në vitin 2026) Pas këshillimit të drejtorit të urbanizimit Ne I jemi drejtuar Infra kosit me kërkesë si qytetarë. Edhe pse infra kosi nuk ka pasur të shpallur ofertë publike për dhënie me qira të asaj parcele. Parcela ka qenë e ndarë 250 metra katrore në mënyrë interno nga infra kosi...

(ndërhyjnë kryesuesi duke thënë se lënda është në gjykatë dhe derisa të jep përgjigjen gjykata komuna nuk mund të bëjë asgjë. Fillon prap një debat interaktiv)

Me datë 28. 05. Kemi pranuar përgjigjen nga Infra kosi I cili thotë se parcela është e uzurpuar nga Adnan Shala edhe realisht me 29. 05. 2024 është njoftuar Komuna, zyra e kryetarit edhe stacioni policor në Klinë dhe është kërkuar lirim I pronës së uzurpuar. Pas kërkesës për lirim të pronës, me 11.12.2024 Infra kosi e ka pajisur personin me kontratë për shfrytëzim të parcelës. Edhe përkundër se ka dërguar kërkesë që të lirohet prona. Një paradox tjetër I Komunës së Klinës ka qenë se në dëgjim buxhetor me 25. 6. 2024 kemi marrë pjesë dhe kemi ngritë nevojën dhe kërkesën për ndërhyrjen e Komunës në çështjen dhe zgjidhjen e problemit të rrugës. Pika e dytë ka qenë realisht në atë debat, projektet zhvillimore të komunës së Klinës, ku unë kam marrë fjalën dhe I kam propozuar që të ngritet çështja e inventarizimit të tokave të komunës por në procesverbal është hequr debate I rrugës që unë kam folur gjithashtu. Kryetar, Zenun Elezaj, rruga është në gjendje të keqe. Çdo ngricë paraqet rrezik permanent për mos mundësinë e frenimit të automjetit. Kycja e rrugës "Azem Desku" që është bërë nga Komuna, nuk ka pellg por ka kycje direkt në rrugën kryesore. Çdo lëvizje dhe kycje në rrugën kryesore nga rruga në fjalë krijon shkelje nga ngasësi I veturës. Kur është ndryshuar rruga, nga 9% e pjerrtësisë, ndryshimi I rrugës ka krijuar 11% të pjerrtësisë. Klina e ka pozitën gjeografike më të ulët në Kosovë, kjo rruga krijon 11% të pjerrtësisë ndërkohë që maksimumi në terrenet më të ngritura duhet të jetë vetëm 12%. Pas zgjedhjeve ne kemi qenë në polici, me 14 tetor dhe kemi dhënë intervistë por e deklaroj me çdo përgjegjësi se në këtë çështje është e inkriminuar edhe policia e Kosovës, stacioni në Klinë. Për arsye se çdo informacion, padi, ankesë, denoncim nuk guxon të ndalet vetëm në stacion policor por të shkoj në instance më të larta të sigurisë. Ne kërkojmë çasje të rrugës "Azem Desku" në Rrugën "Ilir Merturi" sikurse para vitit 2013.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Unë në debat qendror kur diji pyetjen kur shtrohet jap informata aq sa dijë. Mendoj që janë dy çështje. Rrugën nuk e kam punuar në kohën e qeverisjes sime. Besoj që ti ke qenë në qeverisje atëherë por kjo nuk do të thotë që ajo që nuk është

mirë të mos bëhet mirë. Ajo rrugë është bërë me buxhet të komunës por tani e tutje çfarëdo që mund të behët do të bëhet. Bashkërisht...

(kishte ndërhyrje nga z. Geci rreth dilemës se a ka qenë në pushtet apo s'ka qenë z. Geci në kohën kur është bërë ai ndryshim i trasesë që është debat shumë i ngatërruar dhe i pamundur që të shënohet në procesverbal pasi që njëra palë nuk kishte mikrofon të ndezur)

Jemi të gatshëm që bashkërisht me ekipin projektues që të rregullojmë sa të mundemi. Kërkoj nga drejtorja e urbanizimit të na informoj për leje të dhënë ndërtimore. Sidoqoftë....

(ka ndërhyrje nga z. Geci i cili pa mikrofon kërkon që kryetari ta shpall zonë me interes të përgjithshëm)

Do ta shikojmë edhe atë mundësi që ta shpallim zonë me interes të përgjithshëm.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizimit: Për çdo pakënaqësi apo dyshim, kemi organe të sigurisë që pala mund të i drejtohet. Sa i përket lejes së ndërtimit, në atë moment që pala i plotëson obligimet ligjore do të pajiset me leje. Unë e diji se ta kam kthyer përgjigjen dhe të kam thënë se parcela është në pronësi të infra kosit dhe ne nuk mund të përvetësojmë pronën e infra kosit. Paraprakisht duhet të marrim pëlqim nga infra kosi për ndërhyrje. Të kishte qenë pronë e komunës do të flisnim ndryshe. Nëse ndërhyjmë në pronë të infra kosit konsumojmë vepër penale

z. Enver Berisha, kryesues: Pra, kryetari e tha se bashkë me drejtorinë e urbanizimit do të dalin në vend dhe të shohin se çfarë mund të bëjnë.

z. Esat Raci: Nëse nuk gaboju këtë kërkesë të qytetarëve e kemi pasur edhe në vitin 2024 dhe e kemi përkrahur fuqishëm. Edhe tani e përkrahim fuqishëm dhe kërkojmë që atyre qytetarëve të ju bëhet zgjidhje.

Pika 25 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje.

z. Tunë Dedaj: Kam dy kërkesa për dy drejtorë. 1. Për drejtorin e shërbimeve publike që të rregulloj "Urën e Haxhisë" se është bërë shumë gropa si dhe rrugën në Videjë. 2. Për drejtorin e Urbanizimit. Për rregullimin e lumit "Drini i Bardhë" Janë marrë disa prona, ose të na bëjnë kompensimin ose të kthehet në gjendjen e mëparshme përndryshe unë lëndën e qoj në gjykatë.

z. Esat Raci: Për drejtorin e kadastrit: A mund të na informoni për shqetësimin e banorëve të fshatit Zajm, pse po protestojnë ata. Kërkesë që Brenda mundësive të ju dilet në ndihmë atyre qytetarëve.

z. Nikson Daka, drejtor i Kadastrit: Protesta nuk është dashur të behet fare në Komunë. Sa i përket anës së kadastrit krejtësisht është Brenda ligjit.

z. Naim Musliu: Kam disa pyetje por meqenëse thatë që duhet vetëm një po e zgjedhë atë që është më urgjente: hapësira tek banesa e veteranëve është hapësirë ku qëndrojnë dhjetëra qenë endacak dhe nëse nuk merën masa, dikush nga banorët ose nxënësit ka

me e pësuar nga ata qenë endacak. Ju lutem shumë që të ndërmarrin masa organet kompetente.

Znj. Marqe Selmanaj: Kam një pyetje për drejtoreshën e bujqësisë. Kjo drejtori ka shpërnda shumë subvencione. Kërkesa ime ka qenë që të bëhet diskriminim pozitiv sa l përket gjinisë femërore. Pyetje tjetër është për trotuarin në Zllakuqan që është në gjendje të mjerueshme.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizimit: Me të filluar Pranvera do të intervenojmë në trotuarin në Zllakuqan pasi që kontrata është tre vjeçare me kompaninë. Për kërkesën e Runës: Duhet kërkuar kompensim nga niveli qendror.

z. Tunë Dedaj: Kur ma ka marrë mua pronën ma ka marrë komuna nuk ma ka marrë ministria. Dhe atëherë na është thënë që do të behët kompensim ose ndërrim prone. Ose bëjeni shpronësimin ose ktheni në gjendje të mëparshme dhe jemi në rregull.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Tunë, ne kemi marrë një vendim por ministria e linjës na e ka kthyer të jashtëligjshme. Ne kemi bërë të pamundurën si Komunë. Prona nuk është e komunës, menaxhohet nga Ministria e infrastrukturës dhe planifikimit hapësinor. Tash ka nisur iniciativa e ministrisë rreth rregullimit të shtretërve me buxhet qendror dhe do të kemi rastin që ta zgjedhim këtë punë. Sa l përket trotuarit në Zllakuqan, kemi informatë se ajo rrugë do të bëhet 4 krosi por kjo nuk e mbron shqetësimin tënd të drejt sepse kompania ka obligim, punimet e saj nuk janë pranuar.

z. Kushtrim Haliti: Për drejtorin e shërbimeve publike: Një kërkesë që kam bërë në emër të fshatit Jashanicë a të ka ardhur dhe çfarë do të behet për dëmet e vërshimeve në rrugën e fshatit.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SH.P.: Po e kam marrë kërkesën. Ne jemi duke punuar rreth vlerësimit të dëmeve dhe posa të përfundojmë këtë raport do të dalim bashkë në atë pjesë dhe do të intervenojmë. Edhe pyetja që bëri Esati më herët rreth komisionit për vlerësimin e dëmeve., Drejtoria ka pranuar 290 kërkesa për vlerësim të dëmeve, deri sot komisioni ka arritur që të vlerësoj rreth 90% të kërkesave dhe deri nga fundi l javës komisioni do të përfundoj vlerësimin e më pastaj do të dërgohet tek komisioni l menaxhimit të emergjencave. Sa l përket shqetësimit të Naimit për qentë endacak, fatmirësisht kemi kontratë për trajtimin e qeneve endacak por temperaturat në minus rekomandon që mos të veprojmë sepse nuk ka efekt.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Komisioni për vlerësimin e dëmeve ka edhe dy tre ditë punë dhe nuk kemi mundur që ta sjellim në kuvend, nëse ka pajtueshmëri me shefat e grupeve , do të ishte mirë që të përgatisim raportin dhe të jua dërgojmë sepse nuk kemi kohë pasi që duhet të dërgohet ai raport deri nga data 10 shkurt. Do të diskutojmë me shefat e grupeve.


z. Kushtrim Haliti: Ne do të donim që ta kemi raportin në seancë sepse kemi dëshirë të japim mendimin tonë.

z. Armend Beqiri: Pasi që është çështje e ndjeshme pajtohem me kolegun dhe do të ishte më mirë të thirret një seancë e jashtëzakonshme.

Me përfundimin e kësaj pike të rendit të ditës, kryesuesi, z. Enver Berisha shpall të mbyllur seancën duke falënderuar të gjithë për kontributin e dhënë.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesues:

Enver Berisha

